



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15 Prill 2021

Nr: 236

VENDIM

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 37 DATË 17.12.2020, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, “PËR MIRATIMIN E MODELEVE TË DOKUMENTACIONIT TË PUNËS TË KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021”

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronjat “b” e “n”, e 2, dhe 119, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe në pikën 8, të nenit 18, të vendimit nr. 14, datë 10.04.2021, të Komisionit Rregullator, “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Në vendimin nr. 37, datë 17.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, bëhen këto ndryshime:

a) Në fund të pikës 1.6 shtohet përmbajtja, si më poshtë vijon:

Z 08 “Zarfi i të gjitha fletëve të votimit të vlefshme të subjektit zgjedhor”- në format A2 dhe përmasa 44x36;

Model KZAZ-29/1, Procesverbal për votat e vlefshme për partitë politike dhe koalicionet ku nuk ka votim parapëlqyes për kandidatët, letër e thjeshtë format A4;

Model PV KZAZ-31/1, Procesverbal përmbledhës për votat e vlefshme për partitë politike dhe koalicionet ku nuk ka votim parapëlqyes për kandidatët, letër e thjeshtë format A4.



2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

